



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, neneve 15 dhe 34, të Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina dhe për ndryshimin dhe plotësimin Ligji Nr.08/L-071, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011” dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Dragashit, 01.Nr.06-103/1, të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit, në mbledhjen e mbajtur 30.08.2024 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miratoi këtë:

VENDIM PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 1

MIRATOHET Rregullorja për Menaxhimin e mbeturinave.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Menaxhimin e mbeturinave.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të prodhoj efekt juridik, pasi të plotësohen kushtet e parapara konform neneve 81 dhe 82 të LVL-së.

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01 Nr. 060/01-22757-1/24

Dt. 30.08.2024

Kryesuesja e Kuvendit
Arijeta Skeraj





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIC OF KOSOVO

Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš –
Municipality of Dragash



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika (c), nenit 17, pika (f), nenit 40 paragrafi 2, pika (a) dhe (g), të Ligjit Nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, pika a, nenit 15 pika f, dhe nenin 19 paragrafi 1, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, neneve 15 dhe 34, të Ligjit Nr. 04/L-60, për mbeturina dhe për ndryshimin dhe plotësimin Ligji Nr.08/L-071, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2011” dhe dispozitat nenit 28, lidhur me nenin 29, të Statutit të Komunës së Dragashit, 01.Nr.06-103/1, të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës së Dragashit, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.08.2024 miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi:

Kjo rregullore ka për qëllim që të rregulloj çështjen e menaxhimit të mbeturinave komunale, mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe mbeturinat nga aktivitetet tjera, të natyrës së ngjashme me ato të amvisërisë, lartësinë e tarifës së taksës për menaxhimin e mbeturinave nga amvisëritë me qëllim që të krijohet një sistem i qëndrueshëm, për administrimin financiar, ruajtjes së natyrës, ambientit jetësor dhe interesat tjera të përgjithshëm, hartimin e planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, krijimin e kushteve për zbatimin e tij si dhe detyrat dhe përgjegjësit e organit kompetent komunal për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Dragashit në mënyrë që të mbrohet shëndeti publik dhe të zvogëlohet ndikimi i mbeturinave në mjedis.

Neni 2

Fushëveprimi:

Kjo rregullore definon minimizimin e mbeturinave, ndarjen, ruajtjen, shkarkimin, grumbullimin, transportimin, aktivitetet e riciklimit dhe tarifë për mbeturina me qëllim të ruajtjes së mjedisit jetësor të shëndetshëm në juridiksionin e Komunës së Dragashit, në të gjithë territorin e caktuar të komunë dhe ndaj personave fizik dhe juridik.

Neni 3

Përkufizimet:

3.1 Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

3.1.1 **Administrata komunale** - të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal siç përkufizohet në Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare, nr. 28, 04 qershor 2008);

3.1.2 **Gazeta Zyrtare** – Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës;

3.1.3 **Impiant** - objekti me pajisje të dedikuara për kryerjen e procesit të caktuar;

3.1.4 **Komunë** - Komuna e Dragashit, njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin dhe me kufijtë administrativë të përcaktuar sipas Ligjit nr.03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave (Gazeta Zyrtare, nr. 26, 2 qershor 2008);

3.1.5 **Kryetar** - Kryetari i Komunës së Dragashit;

3.1.6 **Kuvend** - Kuvendi i Komunës së Dragashit;

3.1.7 **Ministria** - Ministria përkatëse për mjedisin;

3.1.8 **Mbeturina**- nënkupton substancë, apo objekt që prodhuesi ose zotëruesi e hedh ka për qëllim ta hedhë, apo është i detyruar ta hedhë.

3.1.9 **Menaxhim i mbeturinave** – nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin - rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;

3.1.10 **Operator** - nënkupton personin e pajisur me leje përkatëse mjedisore i cili në përputhje me dispozitat e këtij ligji menaxhon, kontrollon, është përgjegjës për objektet dhe pajisjet e mbeturinave dhe është i autorizuar të marrë vendime në lidhje me funksionet ekonomike ose teknike të pajisjeve dhe objekteve.

3.1.11 **Organe komunale** - nënkupton Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës së Dragashit;

3.1.12 **Leje përkatëse mjedisore**- nënkupton Leje mjedisore ose Leje mjedisore e integruar ose Leje mjedisore komunale, të përkufizuara sipas ligjit përkatës për mbrojtjen e mjedisit dhe Ligjit përkatës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;

3.1.13 **Person** - nënkupton Personin fizik ose juridik, i cili është i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

3.1.14 **Grumbullimi** - grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave, duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe deponimin e mbeturinave me qëllim të transportimit deri në objektet për trajtimin ose deponimin e mbeturinave;

3.1.15 **Ripërdorim** - nënkupton çfarë do operimi, me të cilin çdo produkt apo komponentë që nuk është mbeturinë dhe përdoret përsëri për të njëtin qëllim për të cilin është destinuar;

3.1.16 **Magazinim** - ruajtja e sigurt dhe e përkohshme e mbeturinave në objektet e parapara për këtë qëllim;

3.1.17 **Mbledhje e ndare** - nënkupton mbledhjen e mbeturinave kur grumbullimi i mbeturinave bëhet në mënyrë të ndarë në lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik;

3.1.18 **Menaxhimi i mbeturinave** - nënkupton aktivitetet përfshirë mbledhjen, grumbullimin, transportin, përpunimin - rikuperimin, klasifikimin, deponimin e mbeturinave, mbikëqyrjen e operacioneve të tilla dhe kujdesin, mirëmbajtjen e mëvonshme të vendeve të depozitimit, si dhe veprimet e ndërmarra nga një tregtar ose ndërmjetësues;

3.1.19 **Prodhuesi i mbeturinës** - nënkupton secilin person veprimtaria e të cilit krijon / prodhon mbeturinë, ose çdo njëri që merret me paraprosesim përzierje apo operime tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës;

3.1.20 **Zotëruesi i mbeturinës** - nënkupton prodhuesin e mbeturinës apo personin që e zotëron mbeturinën;

3.1.21 **Mbeturina komunale** - nënkupton:

3.1.21.1 **Mbeturinat e përziera** dhe mbeturinat shtëpiake të grumbulluara veç e veç, duke përfshirë letrën dhe kartuçin, qelqin, metalet, plastikën, mbetjet bio, drunjtë, tekstilet, paketimin, pajisjet e mbeturinave elektrike dhe elektronike, bateritë dhe akumulatorët e mbeturinave, mbeturinat vëllimore, përfshirë dyshekët dhe mobiliet;

3.1.21.2 **Mbeturinat e përziera** dhe mbeturinat e grumbulluara veçmas nga burimet e tjera, kur mbeturinat e tilla janë të ngjashme në natyrë dhe përbërje me mbeturinat shtëpiake;

3.1.21.3 **Mbeturinat komunale** nuk përfshijnë mbeturinat nga prodhimi, bujqësia, pylltaria, peshkimi, tankerët septike dhe rrjetet e kanalizimeve, si dhe nga trajtimi i ujërave të zeza, duke përfshirë llumrat e ujërave të zeza, mbeturinat e automjeteve ose mbeturinat e ndërtimit;

3.1.22 **Mbeturina të rrezikshme** - nënkupton mbeturina që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme të listuara në Shtojcën 1 të Ligjit për mbeturina;

3.1.23 **Mbeturina e parrezikshme**-nënkupton mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme;

3.1.24 **Mbeturina komerciale** - nënkupton mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale dhe që nënkuptohet çdo mbeturinë e prodhuar nga një biznes duke përfshirë por jo kufizuar, në letër, karton, kënaçe, paketim me pakicë dhe mbështjellës ushqimi;

3.1.25 **Mbeturina të veçanta** - mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohen të veçanta sipas nenit 38.4, të Ligjit për mbeturina;

3.1.26 **Mbeturina inerte** - nënkupton mbeturinat që nuk kanë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik apo biologjik në vendet ku janë deponuar si:

3.1.26.1 Mbeturinat inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet e tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

3.1.26.2 I tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë te vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;

3.1.27 **Mbeturinë e vëllimshme** - nënkupton mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportin dhe largim të cilave bëhet në mënyrë të veçantë;

3.1.28 **Mbeturinat ndërtimit dhe rrënimi** - nënkupton mbeturinat e krijuara nga aktivitetet e ndërtimit dhe prishjes;

3.1.29 **Mbeturina ushqimore** - nënkupton mbeturinat e çdo substance apo produkti, qofte i përpunuar, i përpunuar pjesërisht ose i papërpunuar, e që pritet të konsumohet nga njerëzit, pijet, çamçakëzët dhe çdo substance, përfshirë edhe ujin, të përfshirë qëllimisht në ushqim gjatë prodhimit, përgatitjes ose trajtimit të tij;

3.1.30 **Qendra grumbulluese** - nënkupton lokacionin për grumbullimin e mbeturinave të ndara sipas llojeve të përcaktuara;

3.1.31 **Deponi** - vend i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës;

3.1.32 **Konsumator** - personi i cili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin e shërbimeve ose merr shërbime të caktuara sipas ligjit;

3.1.33 **Kompostim** - është procesi i dekompozimit të kontrolluar të mbeturinave organike me qëllim të prodhimit të kompostit;

3.1.34 **PKMM** - Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave;

3.1.35 **Statut** - Statuti i Komunës së Dragashit me 01 Nr 06-103/1 i datës 11.09.2008;

3.1.36 **SMM** - Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave, që vepron në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike i cili zbaton politikat në fushën e mbrojtjes përcaktuar nga ministritë përkatëse dhe legjislacioni përkatës në fuqi për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale;

3.1.37 **Trajtimi i mbeturinave** - nënkupton të gjitha operacionet e përpunimit ose magazinimit, deponimit, përfshirë përgatitjet para përpunimit ose magazinimit, deponimit të mbeturinave;

3.2. Termat tjerë të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për mbeturina, Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Dragashit;

Neni 4

Llojit e mbeturinave:

4.1 Llojet e mbeturinave të cilat i menaxhon Komuna në bazë të kësaj rregulloreje janë si në vijim:

4.1.1 **Mbeturina komunale** janë mbeturina nga amvisëritë, dhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë;

4.1.2 **Mbeturina inerte** që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiet tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshm në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

4.1.3 **Mbeturina të vëllimshme** - mbeturina me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet e amvisërisë dhe mbyllet;

4.1.4 **Mbeturina nga ndërtimi dhe rrënim** mbeturina të gjeneruara nga aktivitetet ndërtimore;

4.1.5 **Bio mbeturinë** janë mbeturinat të biodegradueshme nga kopshtet, parqet, ushqimit dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat të ngjashme nga impiantet e përpunimit të ushqimit;

4.2 **Mbeturinat komerciale** janë mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industriale;

4.3 **Mbeturina industriale** janë mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimi artizanale dhe veprimtari tjera prodhuese;

4.4 **Mbeturina medicinale** janë mbeturina patologjike të cilat krijohen nga aktiviteti medicinal, si dhe materialet e tjera që përdoren në shërbimet mjekësore;

4.5 **Mbeturinat shtazore** janë mbeturina që krijohen nga amvisëritë, thertoret, mishtoret dhe aktivitetet e tjera të ngjashme;

Neni 5

Përfshirjet:

- 5.1 Nga kjo rregullore përjashtohen mbeturinat në vijim:
 - 5.1.1 Mbeturinat e rrezikshme dhe
 - 5.1.2 Llumi/ balta dhe mbeturina të ngjashme;
- 5.2 Menaxhimi i tyre rregullohet në bazë të akteve nënligjore të miratuar nga organi kompetent;

Neni 6

Përgjegjësia e Komunës për Menaxhimin e Mbeturinave:

- 6.1. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm mbi menaxhimin e mbeturinave komunale;
- 6.2. Autorizimi i operatorit që të beje mbledhjen e mbeturinave e dhe jashtë orarit dhe dinamikës së paraparë, sipas nevojës;
- 6.3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave;
- 6.4. Të bëjë monitorimin mjedisor të të gjitha deponive të mbeturinave, që gjenden në territorin e saj;
- 6.5. Të identifikoj pikat ilegale (të zeza) të hedhjes së mbeturinave dhe evitimi i tyre;
- 6.6. Promovimi për minimizimin e mbeturinave (3R, kompostimit shtëpiak etj.);
- 6.7. Promovimi i ngritjes së vetëdijesimit publik - pjesëmarrja aktive e qytetarëve në implementimin e menaxhimit të mbeturinave të ngurta;
- 6.8. Planifikimin buxhetor mbi funksionimin e menaxhimit të mbeturinave;
- 6.9. Propozon përcaktimin e tarifës dhe mënyrën e arkëtimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave, për miratim në Kuvendin e Komunës;
- 6.10. Dorëzimi i Raportit në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor, për MMN çdo 31 mars të vitit pasues;
- 6.11. Komuna ka përgjegjësi që të sigurojë kushte veprimi dhe operimi për operatorët publik dhe privat;
- 6.12. Trajtimi i mbeturinave nga ndërtimi dhe rrënimi, si dhe i mbeturinave inerte, komerciale, të vëllimshme mbrenda territorit të komunës;
- 6.13. Hartimi i planit komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);
- 6.14. Zyrtari komunal të krijoj bazën e të dhënave me shënime për amvisëritë, bizneset dhe institucionet publike dhe private që pranojnë shërbime komunale të grumbullimit të mbeturinave, të cilat shënime (apo regjistra) përmbajnë të dhënat për përdoruesit e shërbimeve, të dhënat personale, adresën si dhe të dhënat e tjera të nevojshme. Këto të dhëna duhet të përditësohen rregullisht nga ana e komunës, përkatësisht nga Sektori mbi menaxhimin e mbeturinave -Drejtoria e Shërbimeve Publike;
- 6.15. Komuna do të bëjë organizimin e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme së paku 1 herë në vit, pa pagesë, sipas planit komunal për menaxhimin e mbeturinave, mbeturina të të vëllimshëm do të dërgohen në deponi komunale;

6.16. Komuna është përgjegjëse që të krijoj bashkëpunim me të gjithë qytetarët, personat juridik publik dhe privat, të cilët kontribuojn në grumbullimin, transportimin, reciklimin e mbeturinave dhe në rruajtjen e mjedisit;

6.17. Komuna propozon Asamblese Komunale sipas ligjeve dhe akteve nënligjore, percaktimin e lokacioneve për krijimin e deponive legale për mbeturinat komunale dhe mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimin, në territorin e saj;

II - SISTEMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Neni 7

Parimet për menaxhimin e mbeturinave

7.1 Mbeturinat në Komunën e Dragashit, mblidhen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbeturina, me këtë rregullore, planin komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM) si dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi;

7.2 Menaxhimi i mbeturinave në territorin e Komunës së Dragashit bëhet duke u bazuar në respektimin e parimeve dhe sipas kuptimeve të përcaktuara në Nenin 5 të Ligjit Nr.04/L -060 për mbeturina, si në vijim:

7.2.1 Parimi ligjshmërisë;

7.2.2 Parimi i afërsisë dhe vetë trajtimit;

7.2.3 Parimi e barazisë e të mosdiskriminimit dhe parandalimit;

7.2.4 Parimi ku ndotësi paguan;

7.2.5 Parimi për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas prioriteteve;

7.2.6 Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit dhe zotëruesit;

7.2.7 Parimi i sigurimit financiar;

7.2.8 Parimi për qasje të publikut në informata;

7.2.9 Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë;

7.2.10 Parim të gjithëpërfshirjes

Neni 8

Organizimi i menaxhimit të mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Dragashit, duhet të organizohet në atë mënyrë që:

8.1 Të mbulohet i tërë territorit i Komunës me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe arritjen e shkallës 100% të grumbullimit dhe transportimit;

8.2 Të bëhet rritja e cilësisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërisë dhe ngritja e kapaciteteve institucionale të menaxhimit të mbeturinave;

8.3 Të bëhet rritja e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e mbeturinave;

- 8.4 Të bëhet rishikimi i procesit tarifor për të siguruar mekanizëm të qëndrueshëm të financimit;
- 8.5 Të bëhet përmirësim i performancës operative dhe financiare të ofruesve të shërbimit;
- 8.6 Të bëhet parandalimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- 8.7 Të parandalohet ndotja nga mbeturinat dhe t'i kufizohet ndikimi kur ajo ndodh në mënyrë që të mënjanohet çdo dëm apo rrezik për mjedisin dhe për shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e jetës së njeriut;
- 8.8 Të ruhet fauna dhe flora, mjedisi e peizazhi nga degradimi dhe sidomos të ruhen burimet natyrore nga ndikimet e mbeturinave;
- 8.9 Të sigurohen shërbime të rregullta dhe të besueshme drejt mbledhjes së mbeturinave dhe trajtimit të tyre të ndarë, në të gjitha fazat e administrimit të tyre dhe të mos përzihen me mbeturinat e rrezikshme;
- 8.10 Të përmirësohet qasja në shërbimet e menaxhimit të mbeturinave nga popullata në zonat urbane dhe rurale në përputhje me politikat qeveritare dhe PKMM;
- 8.11 Të zbatojnë shërbimet bazë të menaxhimit të mbeturinave drejt qëndrueshmërisë dhe mbeturinat t'i nënshtrohen sa më shumë reduktimit, riciklimit dhe ripërdorimit;
- 8.12 Të zhvillohet potenciali ekonomik i ekonomisë qarkore me përfshirjen e grupeve të cenueshme;
- 8.13 Të parandalojnë dhe reduktojnë prodhimin e mbeturinave me qëllim të parandalimit të ndotjes së mjedisit dhe mbrojtjes së shëndetit të njeriut nga prodhuesit dhe zotëruesit e mbeturinave;
- 8.14 Të rritet ekspertiza specifike sektoriale në komunë dhe trajtimi i mbeturinave tu përmbahet standardeve profesionale dhe të bëhet në pajtim me dispozitat e ligjit për mbeturina, këtë rregullore dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
- 8.15 Të përdoren vetëm teknikat dhe metodat më të mira të mundshme të bazuara në kritere mjedisore për ndarjen, grumbullimin, transportimin, ruajtjen, përpunimin dhe asgjësimin e mbeturinave;
- 8.16 Të realizohet një cikël sa më i shkurtër për administrimin e mbeturinave me qëllim që të zvogëlohet koha e ekspozimit të tyre në mjedis;
- 8.17 Komuna së bashku me operatorin të bëjë sanimin e ndotjes dhe dëmit të shkaktuar prej personave fizik dhe juridik të pa përgjegjshëm.

Neni 9

- 9.1 Mbeturinat komunale duhet të mblidhen, transportohen, grumbullohen, trajtohen dhe menaxhohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina dhe me këtë Rregullore;
- 9.2 Komuna ofron sistemin e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave përmes operatorëve të licencuar publik, privat apo publiko-privat;
- 9.3 Mbeturinat grumbullohen nga amvisëritë, institucionet, bizneset, hotelet, restaurantet dhe hapësirat publike, grumbullimi i këtyre mbeturinave do të ofrohet në shërbimin:
- 9.3.1 Sisitem i grumbullimit derë më derë dhe

9.3.2 Në pikat grumbulluese me kontejner-hapësira publike;

9.4 Komuna përmes Sektorit të menaxhimit për mbeturina përkatës, bën përzgjedhjen dhe caktimin e vendeve, pikave grumbulluese të mbeturinave, caktimin e hapësirave për ndërtim të qendrave të mëdha për grumbullim. Pikat grumbulluese caktohen sipas Planit Komunal për menaxhimin e mbeturinave;

9.5 Menaxhimi i mirë i mbeturinave nënkupton: mbulueshmëri me shërbim në tërë hapësirën komunale, shërbim të rregullt dhe cilësor. Standartet cilësore të menaxhimit të mbeturinave përcaktohen në Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave (PKMM);

9.6 Ngritja e vetëdijesimit publik që ka për objektive ngritjen e vetëdijes shoqërore për menaxhimin e mbeturinave, puna me komunitet, palët e interesit, të gjitha institucionet edukativo-arsimore të cilat funksionojnë në territorin e komunës, duhet të edukojnë të gjithë qytetarët në përputhje me rregullat dhe ligjet përkatëse të trajtimit të mbeturinave;

III- KATEGORIZIMI I KONSUMATORËVE, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E GJENERUESVE, BAZA E TË DHËNAVE

Neni 10

Kategorizimi i gjeneruesve të mbeturinave;

Gjeneruesit e mbeturinave kategorizohen si më poshtë:

10.1 Konsumatorët e amvisërive:

10.1.1 Të shërbyer përmes kontejnerëve të përbashkët dhe

10.1.2 Të shërbyer sipas shërbimit derë më derë;

10.2 Konsumatorët komercialë/industrialë:

10.2.1 Dyqanet e vogla zejtare dhe shërbyese;

10.2.2 Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të ulëta të shërbimit;

10.2.3 Subjekte të mesme deri të mëdha komerciale me kosto të lartë të shërbimit;

10.3 Konsumatorët Institucional:

10.3.1 Konsumatorët e vegjël institucionalë;

10.3.2 Konsumatorë e mesëm dhe të mëdhenj institucionalë;

10.3.3 Konsumatorët e mëdhenj institucionalë, të shërbyer me kontratë;

10.4 Detajizimi i mëtejshëm i këtyre kategorive gjendet në shtojcën A të kësaj rregulloreje;

Neni 11

Të drejtat dhe detyrat e gjeneruesve të mbeturinave;

11.1. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë qasjeje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;

11.2. Gjeneruesit e mbeturinave janë të obliguar që të paraqesin ndryshimet e të dhënave përmes kërkesës zyrtare (si p.sh adresën, shitjen e pronës, trashëgimia, dëshmi dhe dokumente të përditësuara etj),

11.3. Çdo gjenerues i mbeturinave ka të drejtë ankese, ndaj shërbimit të ofruar operatorit të kontraktuar.

11.4. Çdo gjenerues i mbeturinave të ngurta duhet të respektoj rregullat e shkarkimit të përcaktuar sipas planit komunal të menaxhimit të mbeturinave;

11.5. Çdo gjenerues duhet të bëjë përpjekje për minimizimin e mbeturinave (përmes 3R, kompostimit shtëpiak dhe formave tjera të mundshme);

11.6. Për shërbimin e ofruar, gjeneruesi obligohet të paguaj tarifën e shërbimit;

11.7. Çdo gjenerues, duhet të bashkëpunoj me autoritetin publik, për të siguruar një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm;

11.8. Ndërmarrjet prodhuese, të cilat gjenerojnë mbeturina, obligohen që operaterit kontraktuar t'ia dorëzojë planin e menaxhimit të mbeturinave, të cilat i gjenerojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë;

11.9. Gjeneruesit e mbeturinave obligohen që mbeturinat e tyre ti hedhin në vende të caktuara nga ana e Komunës për mbledhjen e mbeturinave ndërsa mbeturinat e rrezikshme, ti ndajnë dhe ti dorëzojnë në pikatë mbledhëse apo në vendet e caktuara nga Komuna;

Neni 12

Baza e të dhënave dhe regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale

12.1 Operateri kontraktues publik do të krijoj bazën e të dhënave për të gjithë gjeneruesit e mbeturinave komunale në territorin e kësaj komune, konform Ligji Nr.06/L-082- Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale sipas nenit 5 paragrafi 1.5.

12.2 Baza e të dhënave do të regjistroj të dhënat personale të gjeneruesve, përcaktimin e llojit të mbeturinave nga gjeneruesit, kategorizimin e gjeneruesve, shumën e faturimit të tarifës dhe shumën e inkasimit të tarifës për grumbullimin e mbeturinave, me qëllim të interesit publik për implementimin e planit për menaxhimin efikas të mbeturinave komunale;

12.3 Përgjegjësi e menaxhimit, përditësimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave i takon operaterit i autorizuar.

12.4 Regjistrimi i gjeneruesve të mbeturinave komunale, bëhet me paraqitjen e këtyre dokumenteve:

a) Dokumentin identifikues (letërnjoftimi, pasaporta);

b) Dokumentet e regjistrimit për personat juridik (çertifikata e biznesit ose akt themelimi etj.)

c) Dëshmi - njehsorin e rrymës elektrike;

d) Dëshmi mbi regjistrimin e objektit në tatimin në pronë;

e) Dëshmi e pagesës së faturës për mbeturina në adresën ku ka banuar më parë (në rastet kur gjeneruesi e ndërron adresën e banimit);

f) Dëshmi të çertifikatës familjare (për kategorizim të faturës së tarifës në individë/familje);

g) Në rastet e shitblerjes së objekteve, shitësi dhe blerësi duhet të kenë të paguar borxhin paraprak për mbeturinat në tërësi dhe të paraqesin kontratën e shitblerjes, për të i bërë ndryshimet në data bazë dhe në faturim;

12.5 Gjeneruesit të cilët posedojnë dy apo më shumë fatura të tarifës për mbeturina, për objekte banimi aktive, duhet të lajmërohen tek operaterit i autorizuar për kategorizimin e ngarkesës së faturës;

12.6 Në rastet e dyfishimit të faturave për të njëjtin gjenerues, anulohet/fshihen njëra nga faturat nga baza e të dhënave për menaxhimin e mbeturinave nëse ofronë dëshmi të mjaftueshme;

IV- MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE TË NDËRTIMIT DHE RRËNIMIT

Neni 13

Mbeturinat Komunale nga ndërtimit dhe rrënimi i objekteve ndërtimore

13.1 Gjatë procesit të ndërtimit, meremetimit apo rrënitimit të objekteve, personat fizik dhe juridik duhet të largojnë nga hapësirat ose vendet publike mbeturinat të cilat i krijojnë;

13.1.1 (Komuna do të ndërtojë të paktën dy (2) deponitë në territorin e saj për asgjësimin e materialeve nga ndërtimi dhe rrënimi i objekteve të ndërtimit.)

13.2 Mbeturinat nga ndërtimi dhe rrënimi duhet të hidhen në deponin legale e cila përcaktohet me vendim ligjor nga Kuvendi Komunal i Dragashit;

13.3 Transportimi i këtyre mbeturinave, bëhet nga vetë prodhuesit ose ndërmarrjet për në pikat e mbledhjes së mbeturinave ose në vend deponit e caktuara nga organi komunal;

13.4 Të gjithë personat fizik dhe juridik të cilëve ju lëshohet leje për shembjen ose ndërtimin e objekteve, duhet të veprohet sipas Ligjit për mbeturina Nr.04/L-060, të plotësohet formulari shtojca V për bartjen e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit, nga prodhuesi, transportuesi dhe pranuesi i mbeturinave;

13.5 Secili prodhues i mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit obligohet të veproj në përkujdesje mjedisore, duke vepruar sipas Ligjit Nr. 04/L-60 për mbeturina, Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina, Udhëzimi Administrativ të MMPH Nr.07/2015 për menaxhimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit të objekteve ndërtimore dhe Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Dragashit;

13.6 Të gjithë operatorët publik dhe privat në transportimin e mbeturinave, trajtimin dhe përpunimin, si dhe operatorët në deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit duhet të jenë të pajisur me leje përkatëse sipas Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr.04/L-060 dhe akteve nënligjor të Ministrisë;

13.7 Dorëzuesit e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit në deponin legale për këto mbeturina, duhen të paguaj tarifën e përcaktuar nga Komuna e Dragashit. Pagesa do të bëhet në vendin e përcaktuar më parë nga Komuna;

V- PËRCAKTIMI I TARIFAVE PËR SHËRBBIMET E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Neni 14

Përcaktimi i tarifës për grumbullimin e mbeturinave komunale dhe për deponimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënitimit

14.1 Tarifa mbi mbeturinat komunale faturohet dhe inkasohet nga operateri i autorizuar, faturimi i tarifës së mbeturinave bëhet në bazë vjetore kurse fatura i dorëzohet gjeneruesit të mbeturinave, më së largu deri me datën 10 të muajit pasues;

14.2. Në përcaktimin e tarifës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave të amvisërisë duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

14.2.1 Shpenzimet operative të grumbullimit të mbeturinave (transporti, mirëmbajtja e mjeteve transportuese, burimet njerëzore etj);

14.2.2 Tarifa e pranimit nga deponia e mbeturinave;

14.2.3 Elementet tjera të ndikueshme nga aspekti ekonomik dhe ndikuesit tjerë për menaxhimin sa me efikas të mbeturinave;

14.3. Gjeneruesi i mbeturinave obligohet që të paguajë faturën e tarifës së mbeturinave për çdo muaj të vitit.

14.4 Pagesa e tarifës për mbeturina bëhet në institucionet financiare tek operatorit i autorizuar, përveç nëse komuna merr një vendim tjetër;

14.5 Në përcaktimin e tarifës për pranimin e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit nga objektet ndërtimore, duhet të merren parasysh këto elemente ndikuese:

14.5.1 Shpenzimet dhe mirëmbajtja e ekskavatorit, mirëmbajtja e automjeteve tjera;

14.5.2 Mbulesa me zhavorr, zbrazja e lagunës dhe largimi i borës;

14.5.3 Shpenzimet mirëmbajtjes së zyrës së deponisë (ndriçimi, uji, ngrohja) dhe ato administrative;

14.5.4 Shpenzimet e pagave mujore të punëtorëve të deponisë;

14.5.5 Elemente tjera të nevojshëm për menaxhimin e duhur të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit;

14.6 Kalkulimi dhe përcaktimi i shumës në valutën € (euro) për tarifën e mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit, përcaktohet me vendim të veçantë nga Kuvendi Komunal i Dragashit, sipas elementeve ndikuese nga neni 14 paragrafi 14.6 të kësaj rregullore;

Neni 15

Tarifa mbi mbeturinat komunale të amvisërisë

15.1 Fatura e tarifës komunale për mbeturinat komunale i lëshohet çdo kryefamiljari, individi dhe personave juridik;

15.2 Tarifa komunale e mbeturinave shtëpiake ndahet në tre kategori, në:

15.2.1 Tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë / komunal / individë;

15.2.2 Tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët rezidentë / komunal / familje;

15.2.3 Tarifa e mbeturinave shtëpiake për banorët jorezident / mërgata/familje & individë;

15.3 Tarifa për mbeturinat komunale për konsumatorët komercial, industrial dhe institucionale kategorizohet dhe përcaktohet në shtojcën A të kësaj rregullore;

15.4 Banorët rezidentë janë individë apo familje të cilët jetojnë në vazhdimësi më shumë se 9 muaj në vit, në territorin e komunës ndërsa banorët jorezidentë / mërgata, dhe ata që jetojnë në mbarë Kosovën dhe kalojnë një periudhë të caktuar kohore në komunën tonë, janë individë apo familje që banimi i tyre zgjatë 3 ose më pak muaj në territorin e komunës;

15.5 Individët dhe kryefamiljarët të cilët dëshirojnë të faturohen në kategorinë e taksës komunale të mbeturinave shtëpiake si jorezidentë / mërgata duhet të paraqesin dëshmi se ata qëndrojnë jashtë shtetit për 9 ose më shumë muaj.

Neni 16

Obligimi i pagesës së tarifës për mbeturinat

16.1 Të gjithë gjeneruesit të cilët marrin shërbim mbi grumbullimin e mbeturinave dhe janë të regjistruar në bazën e të dhënave, detyrohen të paguaj tarifën. Nëse gjeneruesi i mbeturinave nuk i paguan 2 këste të njëpasnjëshme (janar - mars dhe prill - qershor), ndaj secilit gjenerues do të iniciohet procedure e përmbartimit tek përmbartuesit privat për pagesë të detyrueshme të borxhit;

16.2. Shkalla e tarifës mund të rishikohet çdo dy vjet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike - Sektori i menaxhimit të mbeturinave, duke marr parasysh performancën e shkallës së inkasimit, etj.

16.3 Kur Kuvendi Komunal në Dragash miraton shkallën e përshtatshme të propozuar për vitin në vijim, njoftohen qytetarët para vitit të ardhshëm fiskal;

16.4 Tarifa minimale e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave tu ofrohet institucioneve dhe bizneseve të mëdha, të kontraktohen individualisht siç edhe është përcaktuar për të ruajtur kualitetin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave;

VI- DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT E OPERATORËVE TË KONTRAKTUARË

Neni 17

Detyrat dhe Përgjegjësit e Operatorëve të kontraktuar për Shërbimin e Mbeturinave;

17.1 Operatori i kontraktuar nga organi kontraktues, për ofrimin e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave duhet të jetë i pajisur me leje dhe është i obliguar që të veproj sipas kontratës të nënshkruar me Komunën e Dragashit, ligjeve në fuqi dhe kësaj rregulloreje;

17.2 Operatori i kontraktuar për menaxhimin e deponisë legale për mbeturinat e ndërtimit dhe mbeturinat e rrënimit është i obliguar që të dorëzojë në komunën e Dragashit "Planin e Menaxhimit të Mbeturinave" për një periudhë 5 vjeçare, për mënyrën e menaxhimit dhe riciklimit të këtyre mbeturinave në deponia ofrohet për menaxhim, mirëmbajtje dhe menaxhim sipas kushteve të përcaktuara me kontratën përkatëse të lidhur ndërmjet komunës së Dragashit dhe operatorit;

17.3 Operatoret e kontraktuar nga organi kontraktues për menaxhimin e mbeturinave dhe për menaxhimin e deponive, obligohen të veproj me përgjegjësi, profesionalizëm dhe të trajtojnë të gjithë gjeneruesit e mbeturinave në mënyrë të barabart, duke i ofruar shërbimin për të gjithë qytetarët në territorin e Komunës së Dragashit;

17.4 Operatori që menaxhon deponinë legale të mbeturinave është i detyruar të paraqesë një raport mujor, i cili tregon sasinë e mbeturinave të dorëzuara në deponi, sasinë e mbeturinave të ricikluara dhe shumën e pagesës së tarifave nga prodhuesi i mbeturinave. Raportet mujore dorëzohen jo më vonë se dita e tretë e çdo muaji pasardhës, Drejtorisë së Shërbimeve Publike, sektorit të menaxhimit të mbeturinave;

17.5 Operatori menaxhues i deponisë legale për mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimit obligohet të dorëzojë raporte mujore, të cilat prezantojnë sasinë e mbeturinave të dorëzuara në deponi, sasinë e ricikluar të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënimit, identifikimin e prodhuesve të këtyre mbeturinave dhe shumën e pagesës së tarifës nga gjeneruesit e mbeturinave. Raportet mujore dorëzohen më së largu në ditë e tretë të çdo muaji vijues, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike - Sektori për menaxhimin e mbeturinave;

VII- MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE VEPRIMET E NDALUARA

Neni 18

Mbikëqyrja inspektive

18.1 Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive sipas dispozitave të nenit 62 deri në nenin 69 të Ligjit për mbeturina nr. 04/L-060 dhe dispozitave tjera të legjislacionit përkatës në fuqi;

18.2 Inspektori komunal për mjedis mbikëqyrë inspekton menaxhimin e mbeturinave në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden në territorin e komunës, duke ndërmarr masat për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

18.3 Inspektori komunal për mjedis, në kuadër të përgjegjësive është i autorizuar të marrë masa preventive për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut si dhe të shqiptojë gjobë për kundërvajtjet e përcaktuara me Ligj dhe legjislacionin përkatës në fuqi;

18.4 Punët e inspektorit për mbikëqyrjen inspektive të veprimtarive për menaxhimin e mbeturinave mund t'i kryej edhe zyrtari me kualifikim adekuat të cilin e autorizon komuna në kuadër të përgjegjësive të veta;

18.5 Në rastet kur Komuna nuk ka inspektor komunal për mjedis, punët, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, i kryen zyrtari komunal sipas paragrafit 4 të këtij neni, i cili kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit;

18.6 Inspektori komunal për mjedis, sipas marrëveshjes nga neni 15 paragrafi 2, neni 65 dhe neni 67 të Ligjit për mbeturina nr. 04/L-060, mund të mbikëqyrë dhe inspekton menaxhimin e mbeturinave edhe në objektet, pajisjet dhe hapësirat që gjenden jashtë territorit të komunës dhe njëkohësisht Komuna mund të lidhë marrëveshje që inspektori mjedisor komunal i komunës tjetër të kryejë inspektimin në territorin e Komunës së Dragashit;

Neni 19

Veprimet e ndaluara

19.1 Në bazë të kësaj rregulloreje ndalohen veprimet si më poshtë:

19.1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotuare, sheshe apo mjedise publike;

19.1.2 Hedhja e mbeturinave të llojeve të tjera në kontejnerë ose në pikat mbledhëse të mbeturinave, të cilat nuk ndahen ashtu siç është parapare;

19.1.3 Hedhja e mbeturinave në hapësirat përbashkëta, brenda dhe jashtë objekteve të banimit kolektiv (ballkone, korridore, tarraca të banesave eti);

19.1.4 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të destinuar për ndarjen e mbeturinave të ricikluara;

19.1.5 Hedhja e mbeturinave në rrugë nga automjetet në lëvizje;

19.1.6 Hedhja dhe deponimi i mbeturinave në hapësirat publike (në rrugë, parqe dhe në vende të tjera publike);

19.1.7 Ndërrimi i vendndodhjes së kontejnerëve, pikave ose vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim të autoriteteve komunale;

19.1.8 Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejnerë, apo në pikat mbledhëse ose ndarëse të mbeturinave;

19.1.9 Shfrytëzimi i mbeturinave si ushqim për kafshë apo të ngjashme, nga kontejnerët ose pikat mbledhëse të mbeturinave;

19.1.10 Shfrytëzimi i kontejnerëve publik nga bizneset, veprimtaritë ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale";

19.1.11 Gërmimi, përzieja, derdhja dhe përhapja e mbeturinave të hedhura në kontejnerë, ose në pikat mbledhëse nga personat e pa autorizuar;

19.1.12 Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të mbeturinave;

19.1.13 Derrdhja apo rrjedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë transportimit për në impiantet për trajtim apo për deponim në deponi të mbeturinave;

19.1.14 Personat e autorizuar për transportin e mbeturinave duhet të marrin masa që gjatë transportimit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë adekuate me qëllim të pengimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë transportit me destinacion tek impiantet për trajtim apo në deponin të mbeturinave;

19.1.15 Mbeturinat nga pajisjet elektrike, elektronike dhe të vëllimshme nuk guxojnë të hedhen në kontejnerë të mbeturinave ose në afërsi të tyre;

Neni 20

Dispozitat Ndëshkuese - Gjobat;

20.1 Ndaj gjeneruesit të mbeturinave, i cili nuk e bën pagesën e taksës për mbeturina do të iniciohet procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente ose me procedura përmes përmbaruesve private, përveç në atyre fshatrave që nuk janë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave;

20.2 Për shkelësit e dispozitave të kësaj rregulloreje, inspektori komunal shqipton gjobë mandatorë sipas, Ligji Nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina;

Neni 21

Kundërvajtjet

Në territorin e Komunës së Dragashit, për mosrespektim të dispozitave të Neneve 71, 73 dhe 74 të Ligjit për mbeturina nr. 04/L-060 dhe neni 49 i Ligjit 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për mbeturina, sipas gjobave të përcaktuara në këto nene, do të dënohen për kundërvajtje dhe gjobiten me gjoba të përcaktuara personat fizik, personat juridik dhe personat përgjegjës në kuadër të personave juridik;

Neni 22

Procedurat e ankesës

Kundër vendimit të inspektorit mund të parashtrohet ankesa në pajtim me Ligjin Nr. 05/L -031 për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare, nr. 20, 21 qershor 2016);

Neni 23

Veprat penale

Kur shkeljet e dispozitave të Ligjit për mbeturina përbëjnë veprë penale sipas Kodit Penal, inspektori komunal përmes kryetarit të komunës bënë kallëzimin penal;

Neni 24

Mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur

24.1 Për të gjitha mbeturinat e hedhura në hapësirat publike ose jashtë deponive të mbeturinave do të përgjigjet vetë hedhësi (subjekti fizik ose juridik) i mbeturinave;

24.2 Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me autorizimet ligjore, nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur dhe nuk mund të identifikohet hedhësi, përgjegjësini për ato mbeturina e bartë vetë Komuna e cila do të ndëmerr të gjitha veprimet që të siguroj largimin e tyre;

VIII- DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Përgjegjësia individuale

Çdo person fizik dhe juridik mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të legjislacionit përkatës për çështjet e menaxhimit të mbeturinave, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, ka bërë kundërvajtje dhe shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi;

Neni 26

Buxheti

26.1 Financimi i menaxhimit të mbeturinave sigurohet nga pagesat e konsumatorëve, Buxheti i Republikës së Kosovës, donacionet dhe burimet tjera financiare në pajtim me legjislacionin në fuqi;

26.2 Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe me legjislacionin përkatës që ka të bëjë me menaxhimin e mbeturinave, organet dhe administrata përkatëse komunale, gjatë fazës së hartimit të buxhetit komunal mund të planifikojnë buxhet për aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave si dhe sigurojnë burime njerëzore, financiare dhe logjistike të nevojshme;

26.5 Kryetari bashkëpunon me Ministrinë përkatëse dhe me donator të ndryshëm për prioritetet për marrjen e fondeve për menaxhimin e mbeturinave;

Neni 27

Regjistri i deponive ilegale

Spektori përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave, në afat prej gjashtë (6) muajve, pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të përgatisë regjistrin e deponive ilegale në territorin e Komunës së Dragashit, sipas dispozitave të Ligjit nr. 04/L-060 për mbeturina.

Neni 28

Zbatimi

Përgjegjës për zbatimin e kësaj rregulloreje në territorin e Komunës së Dragashit janë:

28.1 Sektori / Njësia / Zyrtari përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM) si dhe organet dhe administrata komunale (Drejtoria për shërbime Publike dhe Drejtoria për Punë inspektuese - Inspektori për mbrojtje të Mjedisit me asistencë të Policisë);

28.2 Operatorët e angazhuar për menaxhimin e mbeturinave;

28.3 Të gjithë personat fizik dhe juridik, kalimtarët e rastit dhe turistët dhe që ushtrojnë veprimtari dhe që ndodhen në territorin e Komunës;

28.4 Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike;

28.5 Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Kryetari, me mbështetjen e drejtorit të Drejtorisë së shërbimeve publike dhe / apo udhëheqësit të Sektori / Njësia / Zyrtari përkatës për Menaxhimin e Mbeturinave (SMM);

28.6 Inspektorit për mbrojtje të mjedisit me asistencë të Policisë së Kosovës;

28.7 Administrata dhe Organet komunale janë të obliguara që pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, t'i marrin të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje dhe kryerjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi përkatëse;

28.8 Për të gjitha rastet që nuk janë të rregulluara me këtë rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbeturinave;

28.9 Kryetari mund të nxjerrë Vendime për zbatimin e kësaj Rregulloreje;

Neni 29

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në procedurë të njëjtë me atë të miratimit nga Kuvendi i Komunës së Dragashit me propozimet e arsyetuara nga propozuesi;

Neni 30

Rregullorja do të hyjë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Dragashit dhe pas konfirmimit të ligjshmërisë së saj nga organi mbikëqyrës i MAPL-së (në kuptim të nenit 81, Ligji nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. -28/2008" dhe neni 8 i Rregullores nr. 01/2016, për procedurat për hartimin dhe publikimin e akteve të komunave).

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragash

61 Nr. Br. 060/01-22757-1/24
30.08.2024
Dragash - Dragash



Kryetari i Kuvendit Komunal të Komunës së Dragashit

Arijeta Skeraj

Shtojca A: Tarifat e taksës për mbeturina

1. Kategoria amvisëri: Shërbimi derë më derë dhe me kontenier të përbashkët

Tarifat mujore	5,50€ njësi familjare resident 4,50€ individë 20,00€ jo resident (mërgata)
-----------------------	--

Vrejtje: Në shumën të caktuar është llogaritur edhe TVSH

2. Kategoria e konsumatorëve komercial / industrial : Shërbimi derë më derë dhe me kontenier të përbashkët

Tarifat e taksës së mbeturinave do të caktohet në bazë të hapësirës së objektit	
Bizneset me hapësira prej: 1 – 30m ²	6,50€
Bizneset me hapësira prej: 31 – 50m ²	12,00€
Bizneset me hapësira mbi: 50m ²	21,00€
Kostoja e kontejnerit 1m ³	13,00€ Zbrazje
Kostoja e kontejnerit 7m ³	50,00€ Zbrazje
Deponimi në deponin e qytetit	8 € për ton
Deponimi në deponin e mbeturinave të ngurta	5 € për ton
Tarifa minimale për Shkolla	
Në shkolla tarifat caktohen në bazë të nxënësve dhe punëtorëve të shkollave	1m ² – 0,15€
Tarifa për institucionet e tjera (zyrat lokale, stacionet policore, ambulancat, etj.)	0,15€
Tarifa për pastrimin të qytetit	
Tarifat minimale për pastrimin të qytetit caktohen sipas m ²	1m ² – 0,15€